



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 20.03.2017**

**MARS
2017**

Mbledhjen e drejtoi anëtari i Komisionit për Legjislacion, z. Armend Zemaj

KRYESUESI: Mirë dita të gjithëve,
Faleminderit që keni ardhur sot në dëgjimin publik për Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Të nderuar kolegët e mijë deputetë,
Sot ju kemi ftua në këtë dëgjim publik i cili ka për qëllim të sensibilizoj të gjithë ata që përcjellin këtë fushë që të japin kontributin e tyre në fazat e para të shqyrtimit në Kuvend.

Ashtu siç e keni edhe kodit, projekt kodi është i strukturuar në 142 neni i ndanë në gjashtë pjesë ku secila pjesë është e ndarë në kapituj të veçantë.

Kodi i drejtësi për të mitur ka përcaktuar që çdo person nën moshën 14 vjeç nuk mund të fillohet procedurë gjyqësore por njoftohet organi i kujdestarisë për rastin nga policia pas konsultimit me prokurorinë.

Duke marrë parasysh natyrën e veprës penale të shkaktuar nga personi i mitur, prokurori i shtetit mund të propozoj ndërmjetësim.

Sa i përket masave dhe dënimit brenda këtij kodi ato shqiptohen në varësi të vetë llojit të veprës penale që shkaktohen ku masat që shqiptohen ndahen në masat diversitetit dhe në masat edukative.

Dënimet që mund të shqiptohen tek te miturit janë gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.

Kohëzgjatja çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës me pajtim me kodin.

Duke marrë për bazë edhe elementin e diversitetit janë hartuar edhe disa masa.

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandaloj kur është e mundur fillimin e procedurës gjyqësore ndaj kryesit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe ri-integrimin e të mitur në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste.

Në këto masa hyjnë pajtimi në mes të kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mitur ndaj palës së dëmtuar.

Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij, kompensimi i dëmit të palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor në përputhje me situatën financiare të të miturit, pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij.

Si vazhdimësi e çështje të trajtuar në këtë kod është edhe burgimi për të mitur. Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin, risocializimin dhe në zhvillimin e kryesit të mitur veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur profesional.

Përveç kësaj burgimi për të mitur duhet të ndikoj pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për të parandaluar recidivizmin.

Sigurisht që ky draft ka nevojë për amendamente për kontributin e së cilit do ta ketë mundësi të japë edhe në grupin punues.

Kurse sot jemi të interesuar të dëgjojmë komente dhe propozime nga përfaqësues të institucioneve të cilët jeni prezentë.

Një herë i lus të gjithë ata që propozimet nga diskutimet t'i sjellin edhe me shkrim. Urdhëroni, ne po fillojmë me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë që të arsyetoj projekt-kodin para deputetëve edhe para gjithë të pranishmëve. Faleminderit!

BAKI GIMOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të gjithë këtu të pranishëm,

Fillimisht ju falënderoj shumë për ftesën që na keni bërë për të marrë pjesë në dëgjimin publik për Shqyrtimin e Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur.

Po ashtu më lejoni të falënderoj gjithë akterët relevantë edhe vendor edhe ndërkombëtarë të cilët gjatë procesit të hartimit të projekt kodit na kanë ndihmuar me vërejtje, propozime, sugjerime të gjitha .. i kemi pasur në konsideratë më të lartë në mënyrë që të avancojmë kornizën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Më lejoni që fillimisht të theksoj tri arsye kyçe të cilët e kanë determinua domosdoshmërinë e ndryshimit të kodit dhe drejtësisë për të mitur.

E para është reforma që ka ndodhë në fushën penale . Pra, në vitin 2013 është hy në fuqi kodi penal dhe Kodi i procedurës penale dhe domosdoshmëri ka reflektua edhe në harmonizimin e kodit të drejtësisë për ... të ndërlidhen njëra me tjetrën. Duke marrë parasysh specifikat që i ka Kodi i drejtësisë për të mitur.

Arsyeja e dytë, është të gjeturat nga raporti i progresit i cili referon që duhet të merren parasysh , Qeveria duhet të merr parasysh të gjitha rekomandimet në bazës të analizës që i ka bërë UNICEF-i.

Për këtë rast duhet ta falënderoj shumë edhe UNICEF-in një analizë që e ka bërë, të gjitha ligjet të cilat i preken në mënyrë direkte apo indirekte. Në këtë rast pikërisht edhe te Kodi i drejtësisë për të mitur i cili ka dhënë një kontribut të madh edhe profesional në mënyrë që të gjitha ato rekomandime të inkorporohen në draftin ekzistues.

Arsyeja tjetër, duke marrë parasysh që ky kod ka hy në fuqi në vitin 2010 dhe po thuaj se ka pasur shumë tryeza, mënyra të zbatimit, konferenca të ndryshme me gjyqtarë, prokurorë, shërbimin korrektues sprovues, të gjitha ato informata të cilat i kemi marrë, të gjeturat të cilat i kemi marrë i kemi adresua në Projekt kodin e drejtësisë për të mitur.

Duke marrë parasysh që është voluminoz po mundohemi që në pika të shkurtra t'i përmendi disa nga ndryshime më ... që ka në projekt kodin e drejtësisë për të mitur, të gjitha këto që e kanë avancuar këtë kornizë.

E para është, është zgjeruar numri i parimeve garantuese kushtetuese si dhe janë përcaktuar parimet themelore të cilat institucionet do të merren direkt me të miturit kërkim me konsideratën më të lartë , interesin më të mirë të fëmijëve.

Po ashtu në këtë kapitull është paraparë një kapitull i veçantë siç e potencuat edhe jua i cili i referohet personave të cilët janë nën moshën 14 vjeç, ata janë kryes të veprës penale dhe janë paraparë masat urgjente të cilat shteti duhet të merr parasysh në momentin kur një i mitur vjen ndesh me ligjin i cili është penalisht i papërgjegjshëm.

Është paraparë një kapitull tjetër i veçantë që ka të bëjë me ndërmjetësimin, vërtetë ka qenë ky kapitull por është avancua.

Dhe duke marrë parasysh që thash ne kemi edhe Ligjin për ndërmjetësim në Kuvend, mirëpo është koqitë një sa i përket kualifikimit të ndërmjetësuesve të cilit së paku një ndërmjetësues patë ndërmjetësua në procedurën ...duhet të ketë pesë vite përvojë pune profesionale në fushën për të mitur po ashtu edhe të ketë një licencim ta quaj një profesionalizim të specializuar sa i përket fushës së ndërmjetësimit.

Një risi tjetër shumë e rëndësishme i cili ndërlidhte me parimet garantuese është rritë numri i masave ta quajmë kështu para ndëshkuese pra masa të diversitetit të cilët kanë qenë tetë dhe është rritë numri po thuaj se është dyfishua dhe janë paraparë diku 16 masa të diversitetit.

Të gjitha këto masa janë paraparë kushtet dhe mënyra se si mund të shqiptohen këto masa të diversitetit dhe një risi e veçantë në këtë drejtim është paraparë edhe një masë e diversitetit vërejtja policore të cilën mund ta shqiptoj polici. Në momentin kur një i mitur bie kontakt për herë të parë me ligjin nën-kushte të përcaktuar me kodin e drejtësisë për të mitur dhe në koordinim me prokurorin e shtetit.

Janë paraparë edhe mbajtja e evidencës sidomos për masat e diversitetit dhe masat edukative jo institucionale të cilat mos të kenë karakter të evidencës penale sa i përket të miturit.

Një risi të rëndësishme që kjo ka dalë edhe në bazë të përcjelljes së zbatimit të legjislacionit që ka bërë Komisioni për Legjislacion sa i përket dënimit kur një i mitur është i privuar nga liria dhe është në paraburgim që ajo masë t'i llogaritë në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar në institucionin korrektues si dhe në gjobë dhe në dënim me burgim.

Kjo ka qenë edhe një rekomandim që ka dal nga Komisioni për Legjislacion.

Një risi tjetër shumë e rëndësishme është, është paraparë edhe kontrolli mjekësorë. Jo vetëm në fazën kur një i mitur vendoset në institucionin korrektues por janë paraparë disa faza paraprake në momentin kur një i mitur apo gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson që duhet t'i shqiptohet masa e paraburgimit paraprakisht duhet t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësorë para se t'i shqiptohet edhe masa e paraburgimit e gjitha kjo ka qenë reflektim i analizës dhe standardet ndërkombëtare. Një njësi tjetër është edhe te faza e paraburgimit, siç e dini faza e paraburgimit ka qenë 12 muaj, mirëpo me ligjin e ri kemi tentuar që faza e

paraburgimit të mund të jetë 6 muaj. Në këtë parim duhet që organi që do të merret me zbatimin e këtij duhet ta kenë në konsideratë parimin e urgjencës dhe të merren të gjitha veprimet në mënyrë që mos të zvarritet procedura e paraburgimit për të mitur.

Një njësi tjetër shumë e rëndësishme është pra palët dhe procedurat përgatitore, i cili realisht në bazë të terminologjisë juridike në kohë të një procedurës të merret si procedurë hetimore, por për shkak të specifikave të të miturve përdoret si procedurë përgatitore dhe Kodi i drejtësisë për të mitur iu ka referuar kodit të procedurës penale sa i përket procedurës përgatitore apo hetimore dhe me këtë kod është përshkallëzuar dhe është saktësuar edhe mbajtja apo faza hetimore. Pra, është paraparë që brenda 6 muajve prokurori i shtetit për të mitur duhet ta përfundojë procedurën përgatitore, mirëpo në raste të caktuara kur rasti është jashtë kontrollit të prokurorit të shtetit apo rastet kur kemi të bëjmë me ndërlikueshmërinë e veprës penale, atëherë me një arsyeshmëri dhe bazueshmëri të fortë prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake për të mitur për zgjatjen e paraburgimit edhe për 6 muaj, fazës përgatitore.

Një njësi tjetër shumë e rëndësishme është precizuar edhe një listë e të drejtave, të cilët është vendosur në pjesën procedurale që duhet të jepen të miturit qoftë me shkrim apo edhe me gojë dhe janë listuar diku 12 të drejta, të cilat janë në harmoni edhe me direktivën e Bashkimit Evropian, të cilat duhet të jepen me shkrim dhe me gojë të merret para se të fillojë procedura përgatitore. Është edhe pjesa organizative sa i përket të trupit gjykues që kemi pas përpara gjyqtarë paragjyqësor, tash është ristrukturuar edhe trupi gjykues për cilat raste vendos gjyqtari individual, për cilat raste vendos trupi gjykues dhe kolegji gjykues.

Një njësi tjetër shumë e rëndësishme është zgjeruar numri i veprave penale, të cilat gjyqtari për të mitur i gjykon madhorët në pajtim me Kodin e Procedurës Penale për disa vepra penale ku pjesë e saj është domethënë është viktimë është i mituri apo fëmija në përgjithësi. Pra, për këto vepra gjyqtari për të mitur i gjykon madhorët në pajtim me Kodin e Procedurës Penale nëse nuk është paraparë ndryshe me dispozitën e këtij kodi.

Një dispozitë tjetër, një kapitull tjetër shumë i rëndësishëm është edhe mbrojtja e viktimave apo dëshmitarëve. Nëse i referohemi Kodit të Procedurës Penale, neni 27 thotë që kjo pjesë mbrojtja e viktimave apo dëshmitarët rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur apo me ligjin e veçantë dhe është paraparë një kapitull i veçantë sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave të fëmijëve në përgjithësi dhe të miturve. Pra, qoftë procedura e marrjes në pyetje, masat

mbrojtëse që duhet t'i ndërmerr shteti qoftë policia, prokuroria e të gjitha mekanizmat tjerë në mbrojtjen e interesave më të mirë të fëmijëve.

Kjo ke në pika të shkurta një rezymë e shkurtë duke marrë parasysh e ka shumë gjëra për të diskutuar, mirëpo u mundova t'i përmbledh në pika të shkurta në mënyrë që ne do të jemi të gatshëm edhe në grupin punues kudo që shqyrtohet edhe në kontributin dhe arsyetimin tonë për secilin dispozitë veç e veç. Faleminderit!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! po ashtu edhe komisioni ka qenë i interesuar që të bëjë ndryshimet në Projekt Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Më vjen mirë që i keni përfshirë rekomandimet që kanë dal nga monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit edhe për ekzekutimin e sanksioneve penale, besoj që edhe të tjerët kanë diçka për të na thënë për të kontribuar.

Kemi pa disa elemente që janë dhënë edhe në vërejtjet ta quaj kështu kushtimisht në seancë plenare, para se të kaloj fjalën te kolegët e mi deputetë, urdhëroni kush e donë fjalën paraqituni dhe prezantohuni për shkak të transkriptit. Urdhëro!

FATMIRE HALITI: Përshëndetje për të gjithë, unë jam Fatmire Haliti nga Qendra kosovare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës. Organizata jonë është organizatë jo qeveritare, e cila është themeluar prej vitit '99, ndërsa prej vitit 2006-2007 bën monitorimin e rregullt të institucioneve të vendit të privimit nga liria duke përfshirë edhe institucionin korrektues për të mitur në Lipjan.

Përveç monitorimit të drejtave të njeriut në ato institucione dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit për at kategori ne gjithashtu edhe trajtojmë viktimat e dhunës në familje, dhunës seksuale, si dhe viktimat e luftës. Domethënë me këtë projekt kod ku janë të përfshirë si personat kryerës të mitur gjatë procedurës penale, po ashtu edhe personat që janë viktimë apo dëshmitarë të procedurës penale.

Ne përshëndesim hartimin e këtij drafti, zotëria nga ministria e përmendi risi, risi dhe me të vërtetë është gjithçka risi në këtë kod. Unë e përshëndesim punën që ka bërë grupi punues, fatkeqësisht ne s'kemi qenë edhe pse kemi pas interesim për me qenë pjesë të grupit që nga fillimi, megjithatë ne e kemi arrit me e marrë draftin që është në diskutim dhe kemi disa komente dhe vërejtje tona. Fatkeqësisht nuk i kam të gjitha të shkruara, mirëpo unë do t'i kisha përmend vetëm vijat e trasha të cilat pika ne kemi komente dhe besoj që na jepet mundësia brenda 1-2 dite do t'ju përcjellim edhe në formë të shkruar.

Ne kishim nisë pasi që ky ligj do të zbatohet kryesisht nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe mandej edhe nga personeli për ekzekutimin e masave dhe dënimeve për të mitur. Është shumë e rëndësishme që të jetë i qartë, të jetë i unifikuar prej fillimit deri në fund. Gjatë leximit të këtij projekt kodi dhe analizës së tij pash që me siguri janë marrë parasysh të gjitha komentet dhe propozimet prej të gjitha grupeve që kanë marrë pjesë në grup punues dhe nëse e lexon prej fillimit deri në fund e sheh që është pak i shkapërderdhur apo nuk është një terminologji unifikuese prej fillimit deri në fund.

Kjo gjë do t'i paraqet besoj vështirësinë në zbatim prokurorëve dhe gjyqtarëve sidomos duke u nis prej qëllimit të kodit, qëllimi i kodit është shumë i përgjithësuar, i ka diku 20 rreshta si qëllim. Qëllimi duhet të jetë specifik, i qartë edhe të ketë një përmbajtje të dihet domethënë se çka përmban ai kod. Mënyra se qysh është përshkruar në fillim domethënë neni 1, qëllimi i kodit unë kisha propozuar që të riformulohet prej fillimit le të dihet se cili është qëllimi kryesor e mandej të dihen edhe pikat tjera që e përshkruajnë.

Po ashtu, te parimet e përmendi zotëria nga ministria që kanë përfshirë edhe shumë parime tjera që mbrojnë interesin e të miturit që është shumë e mirëseardhur kjo që ka përfshirë, mirëpo edhe këtu domethënë ka shpeshherë mos përputhje apo nuk mund ta interepertojsh drejt se çka kanë dashur të thuhet. Nëse i merr një prokuror ose gjyqtar i lexon këto parime unë besoj që ka me pas shumë problem në zbatimin e këtyre parimeve. Sidomos është te konsiderata mbizotëruese për të mitur është përmend disa herë në atë mirëpo nuk e ka një sqarim se çka nënkupton konsideratë mbizotëruese tash e kemi fjalën që kanë me e zbatuar këtë ligj prokurorët dhe gjyqtarët. Mandej, e kemi konceptin e qasjes miqësore, duhet të ketë koncept të qasjes miqësore. Çka nënkupton kjo? Ne kemi shumë parime, mirëpo në praktikë nuk e di se si do të zbatohen ato.

Po ashtu ishte edhe një risi tjetër në këtë kod, edhe personat e moshës madhore të ri që nënkupton personat mbi moshën 18 dhe nën moshën 21, 18 deri 21. Dhe sipas këtij projekt kodi domethënë u jep mundësi gjykatës që të mund t'i zbatojë edhe dënimet apo procedurën e të miturve ndaj kësaj kategorie. Ne si organizatë domethënë e kemi vlerësuar dhe propozojmë që mos të mbetet vetëm me ... por le të specifikohet procedura se në cilat raste mund të zbatohet procedura penale e të miturve ndaj personave madhor të ri, domethënë personat të moshës 18 deri 21, se mandej mund të ketë probleme dhe ankesa të vazhdueshme pse për një rast apo procedurë të zbatohen ato dispozita, ndërsa për një procedurë tjetër nuk zbatohen.

Pra, le të jenë të specifikuara se në cilat raste mund ta zbatojë procedurën e të miturve apo në cilat raste mund të shqiptojë dënime për të mitur. Një çështje tjetër e rëndësishme po e shoh që janë këtu prezent edhe përfaqësuesit nga UNICEF-i dhe kanë qenë pjesë me siguri pjesë e grupit punues. Është procedura e ndërmjetësimit, unë përveç që jam juriste jam edhe ndërmjetësuese e licencuar, po ashtu e kam ndjekur edhe trajnimin e ndërmjetësimit për të mitur. Është mirë që e kanë zgjeruar pak a shumë procedurën për të mitur në këtë fazë mirëpo mendoj janë dyfishuar standardet dhe kriteret për ndërmjetësimin e procedurës për të mitur.

Unë ju kisha rekomanduar që në këtë fazë pasi që është plotësim ndryshimi ende le të bëhen kriteret në bazë të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të ketë kriterë ekstra, për shembull fillon aty duhet të ketë përvojë 5 vjeçare, duhet të jetë jurist i diplomuar, jurist i diplomuar tani vetëm se nuk ka si profesione nuk duhet të kufizohen, mirëpo mendoj se le të jetë si parim i përgjithshëm për ndërmjetësuesit për të mitur, të jetë ndërmjetësuesi i licencuar sipas Ligjit për ndërmjetësim pasi që edhe Ligji për ndërmjetësim ende është në plotësim ndryshim, si dhe dy kriterë shtesë të ketë 5 vjet përvojë ashtu siç është dhe të ketë trajnimin për ndërmjetësim për të mitur, jo domethënë licencim ekstra apo certifikim ekstra mirëpo të ketë trajnime të vazhdueshme për të mitur.

Një çështje tjetër e përmendi prapë zotëria, po më vjen keq se të gjitha to që i përmende i kam shënuar se kam pas më shumë komente në ato pika, te vërejtja policore. Ne si organizatë monitoruese i monitorojmë personat që nga momenti i parë i privimit nga liria, domethënë që nga momenti i arrestimit dhe realisht deshëm apo s'deshëm ta pranojmë vërejtjet policore jo në mënyrë ligjore, apo në mënyrë të shkruar, po ka vazhdimisht në momentin që arrestohet një i mitur sigurisht që do ta marr një vërejtje nga polici edhe pse s'ka autorizime që s'ka kompetencë, mirëpo jep një vërejtje pse e ke bërë atë vepër a pse s'e ke bërë, pse... s'është dashur me e bë atë.

Te vërejtja policore unë kisha propozuar te mënyra e shqiptimit le të parashihi kushtet, mënyra dhe si zbatohet. Janë këtu tre paragrafë, mënyra se si shqiptohet, mirëpo duhet të ketë procedurë më specifike se si do ta shqiptojnë policët atë vërejtje policore.

Po ashtu, te terminologjia kishte shpeshherë gjëra që bien ndesh njëra me tjetrën apo titujt e neneve në disa raste ishin jo adekuatë. Pastaj, ndoshta edhe te përkthimi ka pasur problem, kur është përkthyer ligji kanë mbetur disa terminologji që janë përkthyer në mënyrë shabllone ashtu pa u menduar, as pa ia dhënë kuptimin në gjuhën shqipe. Kjo është në përgjithësi komentet apo vërejtjet që i kemi. për detaje

të tjera ne mund ta bëjmë edhe në formë të shkruar dhe t'ia dërgojmë të gjithë grupit punues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonjë, për kontributin e juaj! Po ashtu, ju lutem që t'i sillni me shkrim në afatin sa më të shkurtë kohor, sepse grupi punues do të punojë edhe në pjesët tjera. Sigurisht, se edhe do të ju ftojme po që se dëshironi që t'i mbronin ato propozime edhe para grupit punues. Kur të punojmë janë të mirëseardhura edhe pse sigurisht, se do të merrni përgjigje, mirë është që në mënyrë kronologjike të përcillen nga neni në nen, sepse e kanë edhe lidhshmërinë ndërmjet tyre, sidomos të masat e reja edhe të pjesa që lidhet edhe me evidenca dhe me masat edukative. Faleminderit!

Urdhëroni dikush tjetër! Urdhëroni!

ARDIAN KLAIQI: Faleminderit, Armend!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Unë jam Ardian Klaiqi. Jam zyrtar i Drejtësisë për Fëmijë në zyrën e UNICEF-it në Kosovë.

Dëshiroj të ju falënderoj për ftesën, fillimisht dhe njëkohësisht për mundësinë që edhe ne të japim kontributin tonë në këtë dëgjim publik. Ne si zyrë e mandatuar nga Kombet e Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve, gjithsesi kemi qenë së bashku me Ministrinë e Drejtësisë në procesin e rishikimit të Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe gjithë ato që i përmendi përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, ne si UNICEF i mbrojmë dhe qëndrojmë pranë tyre dhe dëshirojmë të theksojmë që shumica e këtyre ndryshimeve dhe risive, që janë të parapara në këtë projekt-kod janë në përputhje, fillimisht me Konventën e të drejtave të fëmijëve dhe akteve kryesore ndërkombëtare, që rregullojnë procedurat e mbrojtjes së të miturve gjatë procesit gjyqësor dhe ligjor, në përgjithësi, duke filluar nga rregullat e Pekinit, të Tokios, Riadit, rregullat e Havanës dhe së fundmi, direktivat e Bashkimit Evropian që rregullojnë këtë fushë.

Unë dua t'i theksoj risitë kryesore që janë ndoshta 4 risitë më të mëdha që ka pësuar ky kod dhe janë plotësisht në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe në trendin e zhvillimeve nga fusha e drejtësisë apo reformave të drejtësisë për të mitur, duke filluar nga kapitulli që do të rregullojë pjesën e përgjegjësisë penale apo thënë më mirë, kur fëmijët janë kryerës të veprës penale, mirëpo për shkak të moshës nuk mund të iniciohet procedurë dhe ne kemi rregulluar, që kjo çështje do të duhej në të ardhmen, përmes një rregullative apo një rregulloreje të Qeverisë, të

procedohet dhe te rregullohet mbrojtja e fëmijëve kur janë kryerës të veprave penale. Sepse, ju e dini që në bazë të statistikave, kjo moshë apo kategori e fëmijëve janë kryerës të shumë veprave penale dhe andaj edhe është paraparë dhe ka qenë kërkesë e vet sistemit prokurorial dhe gjyqësor, që kjo çështje të rregullohet me procedurë.

Pastaj, masat e diversitetit është shumëfishuar ashtu siç e përmendi edhe përfaqësuesi i ministrisë, u është dhënë mundësia më e madhe prokurorëve, që fëmijët veçanërisht të mos futen në pjesë të procedurës së rregullt gjyqësore që njihet, ndaj edhe masat e diversitetit kanë këtë qëllim e veçanërisht, mundësia që është dhënë sistemit, në këtë rast, policisë së shtetit që të shqiptojë vërejtjen policore si një prej masave të diversitetit. Dhe, llojllojshmëria që është paraparë këtu ka pikërisht qëllimin për parandalimin e veprave penale dhe risocializimin dhe riedukimin më të mirë të të miturve në procedurë.

Pastaj, një gjë që ka qenë një shkelje shumë e rëndë viteve të kaluara, ka qenë çështja e stërzgjatje së paraburgimit, kur fëmijët janë mbajtur në paraburgim ne sipas statistikave kemi pasur raste kur fëmijët janë mbajtur në burgim deri në 18 muaj që ka qenë edhe vetë shkelje e ligjit, por edhe të gjitha standardet ndërkombëtare, andaj tani me Projektkodin e ri, ne kemi një shkurtim që është në përputhshmëri me vetë sugjerimet dhe këshillat që Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve u ka ofruar të gjitha shteteve që janë nënshkruese të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve që paraburgimi në asnjë rrethanë të mos kalojë mbi 6 muaj.

Pra, ky projektkod ka reflektuar edhe këtë rekomandim të Komitetit të Drejtave të Fëmijëve.

Dhe, kapitulli i fundit, që është ndoshta edhe risi shumë e madhe, dhe shumë e rëndësishme – është kapitulli që rregullon pjesën e viktimave dhe të dëshmitarëve.

Kjo deri tani nuk ka qenë e rregulluar në Kosovë, fatkeqësisht. Dhe fëmijët kur kanë qenë viktimë edhe dëshmitarët e një procesi gjyqësor, jo vetëm se kanë qenë viktimë e veprave penale, por kanë qenë viktimë e dyfishtë, edhe të veprave penale mirëpo edhe të mungesës së procedurës dhe shkeljeve që janë bërë gjatë procesit gjyqësor.

Andaj ne, si Zyrë e UNICEF-it qëndrojmë pranë këtyre ndryshimeve dhe jemi të gatshëm që ta mbështesim edhe Grupin punues që eventualisht me sugjerimet, këshillat, vërejtjet që do të jepen edhe nga shoqëria civile dhe organizatat që nuk

kanë qenë pjesëmarrëse. Dua të them, të shikojmë e përmirësojmë dhe avancojmë edhe më tutje Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Ardian! Urdhëroni, ju atje!

LULJETA KRASNIQI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetët,

Të nderuar të pranishëm,

Unë jam Luljeta Krasniqi dhe bashkë me kolegun tim Rinor Hoxhën, përfaqësojmë OSBE, respektivisht departamentin për të drejtat e njeriut dhe komunitete, sektorin që merret me legjislacion.

Vetëm shkurt, sa për të thënë, fillimisht për ta përgëzuar Ministrinë e Drejtësisë për një punë shumë të mirë që është bërë me Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Ne si OSBE, siç e thanë edhe parafolësit, kemi qenë pjesë e procesit edhe të Grupit të punës dhe përgjatë procedurës së konsultimit publik të kodit, dhe shumica e kontributeve tona që kryesisht fokusohet te pjesa e të drejtave të njeriut dhe parimeve të sundimit të ligjit dhe është reflektuar në Projekt-kodin që ka kaluar në Qeveri dhe është tani në Kuvend.

Megjithatë ka edhe një numër të konsiderueshëm, kisha thënë, më shumë të natyrës teknike, prandaj nuk do të zgjatesha shumë sot për të kaluar nëpër to, e të cilat ne veç i kemi përcjell te Komisioni me shkrim. Pra, i dispononi ato të gjitha me shkrim dhe presim që në takimet e Grupit të punës të jemi të pranishëm dhe të vazhdojmë me kontributin tonë deri në fund sa i përket Projekt-kodit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë, zonja Luljeta! Urdhëroni, kush e do fjalën? Urdhëroni!

IGBALLE RRAHMANI: Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Igballe Rrahmani! Vi prej institucionit të Avokatit të Popullit!

Ju falënderoj për mundësinë që na e keni dhënë të jemi pjesë e këtij dëgjimi publik. Natyrisht se e falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë për punën që e kanë bërë lidhur me Kodin e Drejtësisë për të Mitur!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë pjesë e disa punëtorive, në të cilat veç edhe ka dhënë kontributin e vet sa i përket aspektit të të drejtave të njeriut, natyrisht, me theks të veçantë për fëmijët.

Ajo që mund të them, e që ndoshta lidhet më tepër me aspektin gjuhësor, që do të thotë se ndoshta më tutje do të kihet parasysh që disa nocione të riformulohen, me qëllim që të jenë dispozitat që kanë të bëjnë qëllimin dhe disa gjëra tjera, të jenë unike, më të qarta, të fillohet me njejës e shumës. Do të thotë, për këtë ndoshta do të kihen parasysh më tutje, në mënyrë që ligji të jetë i qartë e i kuptueshëm për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Fjalën e kanë tani kolegët e mi, nëse dikush veç do të marrë fjalën!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Më vjen mirë që shumica kanë fjalë të mira për Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur. Është diçka që edhe vetë Komisioni për Legjislacion ka pritur që të kemi një draft-kod i cili i plotëson kushtet dhe kriteret, por edhe të gjitha ato mangësi që janë evidencuar që nga viti 2010, kur e kishim për herë të parë Projekt-kodin për të mitur, e ne disa që kemi kaluar edhe në procesin e kaluar, edhe të monitorimit të zbatueshmërisë së këtij ligji.

Besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm se është një fushë senzitive. Ka të bëjë me një moshë, e cila është e ndjeshme dhe ne të cilët duhet të jemi shumë vigjilentë që, në aspektin ligjor, jo vetëm atë teknik, por edhe shumë përmbajtjesor, të jemi të vëmendshëm që ta kemi një projekt-kod i cili i plotëson kushtet dhe kriteret sipas konventave që janë të zbatueshme edhe ndërkombëtare, por mbi të gjitha edhe kushtet dhe rrethanave që i ka Republika e Kosovës.

Unë mbetem me shpresë se ne do të punojmë, do të përkushtohemi në afat shumë të shkurtër kohor që ta përcjellim në lexim të dytë, por mbi të gjitha besoj se edhe Ministria e Drejtësisë si sponzorizuese e ka parasysh implementimin e tij, sepse edhe masat e reja kërkojnë kushte, kërkojnë kapacitete, kërkojnë trajnime shtesë dhe mbi të gjitha edhe institucione shtesë korrektuese nga ajo që kemi si Republikë e Kosovës.

Unë po ju falënderoj shumë që sot ishit me ne. Ne do t'ju ftojme në Grupin punues dhe besoj se nuk do të kemi shumë punë që ta përcjellim për lexim të dytë. Faleminderit shumë!